

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	103 dhe 101 vjeç, motër e vëlla nga Pogradeci mbajnë gjallë kujtimet e një shekulli - Euronews Albania
ADRESA	https://euronews.al/103-dhe-101-vjec-moter-e-vella-nga-pogradeci-mbajne-gjalle-kujtimet-e-nje-shekulli/
BURIMI	euronews.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	28 shtator 2026, 15:24:03 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	28 shtator 2026, 15:18:42 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	f8328e97e7ddd36307685294a2626a3743d12e50a21aa68e13d72b607486fbb6
TEKSTI	4b006256e6eff8c4078822ff2bbb916a861934ac344010f5ec553adbb5d125dc
PAMJA	ddcd1d60509ddd183f07bcda318e9a36173d927d720e984e8fab9e785a559923

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	48a856412b9bbfd4190f44224a181bc6db4412b35bcb76d6ad103b61782df93c
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	70759019bbdb922600e92acf251987d45dad965704b935fe53775a49569cfd8
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/48a856412b9bbfd4190f44224a181bc6db4412b35bcb76d6ad103b61782df93c>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.


Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

TREND

Lufta në Iran SHBA Kuvendi i Kosovës Edi Rama Rusia

JETESË | LAJMI I FUNDIT

103 dhe 101 vjeç, motër e vëlla nga Pogradeci mbajnë gjallë kujtimet e një shekulli



28 Shtator 2026 | 17:18

Pandi dhe Artemisi Bardhi janë motër e vëlla nga Pogradeci dhe së bashku kanë më shumë se dy shekuj jetë. Pandi është 103 vjeç, ndërsa e motra, Artemisi, 101 vjeçe. Të dy kanë ruajtur kujtime nga Pogradeci i fëmijërisë, nga pushtimi italian dhe nga dekada të tëra ndryshimesh që kanë transformuar qytetin dhe vendin.

Edhe pse nuk kanë bërë një jetë luksi, por kanë qenë njerëz të thjeshtë dhe punëtorë, sot ata janë ndër banorët më të moshuar të Pogradecit dhe gëzojnë një shëndet të mirë.

Pandi, i cili gjatë gjithë jetës ka ushtruar profesionin e kallajxhiut, e ka parë Pogradecin të ndryshojë brez pas brezi. Mes kujtimeve të tij janë edhe ngjarje që i përkasin historisë së vendit, përfshirë vitin 1939 dhe pushtimin italian.

Sipas Pandit, ushtarët italianë nuk silleshin si pushtues, por ishin njerëz që kërkonin të argëtoheshin ndërsa kujton ditët e para të pushtimit, shitjen e gështenjave dhe takimet me ushtarët italianë.

"Pandi Vangjel Bardhi. Jam e 3 vjet më i madh të shkrojtura atje. Unë e mbaj Pogradecin mend shumë mirë. Shkollën e kam bërë në katundin Kotodesh. Hyri Italia fashiste këtu, pas dy-tre ditëve u shpërndanë, ca shqip, ca italianë. Ne të rinj shisnim gështenja. Vino, grapa, kantare, të qejfit. E ne pas atyre si kalamaj. Nuk ishin katila, ne nuk pamë njeri të rrihej. Vinin këndonin, lavora thoshin. Punë. No guera", thotë Pandi Bardhi.

Përballë tij, Artemisi, 101 vjeçe, kujton jetën e asaj kohe, vitet e vështira dhe punën që e shoqëroi gjatë gjithë jetës. Me profesion rrobaqepëse, ajo tregon se puna ka qenë pjesë e pandarë e jetës së saj.

"Artemisi e kam unë. E bija e Vangjel Bardhit. Datëlindja, dhjetor i 25. Rrobaqepëse kam qenë. Bënim për çupa, për fëmijë. Pantallona, xhaketa. Unë për vete nuk vuajta e atëherë", thotë ajo.

Dy jetë të nisura më shumë se një shekull më parë kanë dëshmuar ndryshime të jashtëzakonshme. Nga Pogradeci i fëmijërisë së tyre te qyteti i sotëm, shumëçka ka ndryshuar, ndërsa të dy thonë se jeta sot është më e mirë dhe më e lehtë.

Kur flasin për vitet e ndërtimit të vendit, Pandi dhe Artemisi e lidhin atë periudhë me figurën e Enver Hoxhës. Kujtimet e tyre për atë kohë mbeten pjesë e rrëfimit personal për një jetë të kaluar me ndryshime të mëdha shekullore.

LAJMI I FUNDIT

17:18 Kallas: BE-ja të koordinojë përgjigjen ndaj sulmeve hibride

16:59 Thatësira dhe kostot e larta godasin misrin, fermerët e Gjergjanit në Elbasan: Nuk na del as qiraja

16:46 Nga bateri të përdorura të makinave elektrike në depo energjie, mundësia e re që po shqyrton Europa

SHPËRNDAJE
ARTIKULLIN

16:41 Avioni bën ulje emergjente në Portugali, pas një problemi në bord

16:41 Pogradec, zjarr masiv në një kodër pranë Mëmllishtit, rrezikohet masivi pyjor me pisha

16:34 Sulm ajror në Myanmar, të paktën 33 persona humbën jetën në bombardime

TESTIM

një jetë të kaluar mes ngjyshmive të mëdha shqiptare.

“As Sali, as Ramë nuk zë me gojë. Enver Hoxha e gjeti të dobët Shqipërinë. Bëri hekurudhën, fabrikën e sheqerit, Enver Hoxha. Këneta Enver Hoxha”, thotë Pandi Bardhi.

“E sot që marr pensionin, për atë e kam. I ndritet shpirti Enverit. Për punës. Më mori me zor, më futi, e tha: kur të krijohen këmbët, të hanë dhëmbët. Do t'i vijë i gjalli të vdekurit. Unë i them Zotit: më merr. Mja pashë në këtë botë. Nuk dua të rroj më. Si budallai, ha, pi e brenda rri. I Greqisë thotë ai: ‘Ajde këtu’”, thotë ajo.

Pandi dhe Artemisi janë një kujtesë e gjallë e një shekulli të tërë. Kanë parë luftëra, breza që kanë ardhur e ikur dhe një qytet që është transformuar përpara syve të tyre. Sot, jetën e tyre e rrethojnë fëmijët, nipërit dhe stërnipërit.

Shiko në:

LAJME TË SUGJERUARA

JETESË | LAJMI I FUNDIT | NJERËZIT E FSHATIT | SOCIALE

Në Slatinë të Mokrës, banorët e fshatit që po boshatiset: Na ka marrë malli për zhurmën e fëmijëve (VIDEO)

Slatina e Mokrës, në Pogradec, është një nga fshatrat ku boshatisja e zonave rurale shihet çdo ditë. Emigrimi, mungesa e punës dhe, mbi të gjitha,...

18:31 | 27/09/2026

EVROPA | JETESË | LAJMI I FUNDIT

Sa aktivë janë europianët në aktivitetin fizik? Sondazhi nxjerr në pah dallimet

Aktiviteti sportiv po bëhet gjithëmonë e më i pranishëm në jetën e qytetarëve në Europë. Mjekët janë ata që e këshillojnë më së tepërmi, si...

18:34 | 23/09/2026

BOTA | JETESË | LAJMI I FUNDIT

Studimi i ri: Moti i ftohtë mund të paralajmërojë rritjen e rasteve të arrestit kardiak

Një studim i ri nga studiues hungarezë tregon se moti i ftohtë mund të shërbejë si një sinjal paralajmërues për rritjen e rasteve të arrestit...

18:52 | 17/09/2026

TEMA

Vendi
Rajoni
Bota
Video

SHËRBIME

Live
Lajmi fundit
Na ndiqni
Euronews Radio
Për persona me aftësi të kufizuara

KOMPANIA

Rreth Euronews
Kushtet e përdorimit
Politika e cookie
Kontakttoni
Punësimi

Follow Euronews on all platforms: